



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.900/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada - Gillogjani, kryesuese, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Flutura Fera - Begunca nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.900/2021 i datës 04.11.2021, i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Flutura Fera - Begunca nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar Rinumërimin e votave në vendvotimet 0701D/01R, 0701D /04R, 0701X/01R, 0702D/01R, 0702D/02R, 0701X02R, 0701X/03R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.900/2021, i ushtruar nga Flutura Fera - Begunca Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se në zgjedhjet e datës 17.10.2021, me numër rendor 07, nga radhët e LDK-së në Kaçanik, pas shpalljes zyrtare të rezultateve, nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, ka dyshime se më janë manipuluar votat në këto vendvotime 0701D/01R, 0701D /04R, 0701X/01R, 0702D/01R, 0702D/02R, 0701X02R, 0701X/03R.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Flutura Fera - Begunca, kërkon korrigjimin e votave në

vendvotimet e lartcekura, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, më të cilin apel kërkon që ti korrigojen votat është i pa bazuar.


Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, e njëjta nuk ka ofruar asnjë dëshmi qoftë formular apo deklaratë, që dëshmojnë ato pretendime të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave në vendvotimet 0701D/01R, 0701D /04R, 0701X/01R, 0702D/01R, 0702D/02R, 0701X02R, 0701X/03R, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, Paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.900/2021 më datën 06.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Affete Sada Glllogjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.